

**URDHËR**  
**Nr. 2363, datë 21.10.2020**

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 9, të ligjit 111/2020, “Për kadastrën”, në funksion të mbarëvajtjes të veprimtarisë administrative dhe të zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë të drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm te drejtori i Njësisë Juridike dhe Kontrollit, znj. Jeta Velaj, nga data 21.10.2020 deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme, për nënshkrimin e autorizimeve mbi të drejtën e përfaqësimit, deklaratave të mbrojtjes, prapësimeve, ankimeve, ankimeve të veçanta, rekurseve, kërkesave për pezullim, si dhe çdo akti tjetër procedural në funksion të mbrojtjes efektive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në proceset gjyqësore.

2. Ngarkohen njësitë në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së dhe znj. Jeta Velaj për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Artan Lame**